| REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - MARS 2026 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **NR. RENDOR** | **DATA E KËRKESËS** | **OBJEKTI I KËRKESËS** | **DATA E PËRGJIGJES** | **PËRGJIGJE** | **MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS** | **TARIFA** |
| **1** | 02.03.2026 | Kërkesë | 04.03.2026 | Në përgjigje të shkresës suaj…Ju sqarojmë se:<br>AZHT, e cila aktualisht kryen funksionin si Sekretariat Teknik i KKTU-së, është krijuar me Vendimin Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT", i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKT,me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU.<br>Për sa më lart, referuar kërkesës Suaj,...pas verifikimeve përkatëse të kryera në databazë,në pronën....nuk evidentoi asnjë aplikim apo vendimmarrje të KKTU.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, | E plotë | Nuk ka |
| **2** | 02.03.2026<br>12.03.2026 | Kërkesë | 03.04.2026 | Në përgjigje të shkresave tuaja…Ju bëjmë me dije se:<br>…......................<br>Në vijim sqarojmë se,pas plotësimit të dokumentacioit tekniko-ligjor,do të vijohet me procedurat e mëtejshme për nënshkrimin e vendimit dhe me lëshimin e Dokumentit të Lejes për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit nga ana e AZHT,bazuar në Ligjin Nr.107/2014,datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar,si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispiozicion pë çdo informacion të nevojshëm. | E plotë | Nuk ka |
| **3** | 02.03.2026 | Kërkesë-Dërgohet dokumentacioni plotësues në lidhje me shkresën…... | 16.03.2026 | Në vijim të korrespondencës së kryer…....ku na vini në dispozicion kartelën dhe hartën treguese të pasurisë…por dokuementacioni nuk është I plotë,pasi mungon plani i rilevimit në sistemin KRGJSH dhe në hartën treguese konturi i pasurisë nuk është i qartë.<br>Për sa më sipër,lutemi të na vini në dispozicion informacionin e saktë të kërkuar,konkretisht planin e rilevimit në sistemin koordinativ KRGJSH dhe fragmentin e hartës së konturuar ku të dallohet qartë kufiri i pronës.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispiozicion pë çdo informacion të nevojshëm. | E plotë | Nuk ka |
| **4** | 02.03.2026 | Kërkesë | 24.03.2026 | Në vijim të korrespondencave të mëparshme si dhe në përgjigje të shkresës suaj….,Ju bëjmë me dije se në lidhje me pretendimet tuaja mbi pezullimin e procedurave nga ana e institucionit tonë,ju kemi kthyer përgjigje me shkresat…..<br>Sa më sipër,ju rikujtojmë se nëse gjatë kësaj periudhe do të ketë vendim të formës së prerë nga ana e gjykatës kompetente apo vendim të ndërmjetëm për kufizimin e veprimeve/vendosjen e masës së sigurimit të padisë mbi pasuritë objekt zhvillimi, lutemi të na e vendosni në dispozicion. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **5** | 04.03.2026 | Kërkesë për informacion mbi lejen e ndërtimit dhe planifikimin urbanistik të një objekti që do të ndërtohet pranë pallatit tonë | 06.03.2026 | Në përgjigje të shkresës Suaj…Ju sqarojmë se:<br>AZHT,e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së,është krijuar me Vendimin Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT", i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar,kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU-së me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU.<br>Për sa më lart,referuar kërkesës suaj,pas verifikimeve përkatëse në databazë, në........nuk evidentoi ansjë aplikim apo vendimmarrje të KKTU. | E plotë | Nuk ka |
| **6** | 06.03.2026 | Dërgim informacioni mbi koordinatat dhe karakterisikat e objektit | 25.03.2026 | **Shënim**:Në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se: *"Kur një organ publik merr një kërkesë,për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet,ia përcjell kërkesën menjëherë,organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë"* , kërkesa është përcjell në organin publik kompetent,ku dhe kërkuesi është vendosur në dijeni për këtë. | E plotë | Nuk ka |
| **7** | 09.03.2026 | Kërkesë për informacion mbi zbardhjen e Vendimit të KKT për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin…... | 16.02.2026 | Në përgjigje të shkresës suaj…Ju informojmë se:<br>…....................<br>…...................<br>Për sa më sipër,ju bëjmë me dije se, institucioni jonë do të vijojë me procedurat e zbardhjes së vendimeve të sipërcituara,vetëm pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e subjektit zhvillues,referuar parashikimeve të VKM-së 408/2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar,gjithashtu ju bëjmë me dije se,referuar legjislacionit në fuqi leja i fillon efektet juridike për zbatim pas lëshimit të dokumentit të lejes në sistemin e-leje.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm. | E plotë | Nuk ka |
| **8** | 09.03.2026 | Letër e hapur | 16.03.2026 | Në përgjigje të kërkesës suaj drejtuar pranë AZHT Ju informojmë se:<br>…...................<br>Në vijim,në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e terriotrit i ndryshuar,dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, KKT….ka vendosur miratimin me kusht të lejes së ndërtimit për aplikimin e sipërcituar,.......<br>Së fundmi,ju informojmë se AZHT nuk do të vijojë me procedurat e mëtejshme pa u plotësuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **9** | 11.03.2026 | Kërkesë | 17.03.2026 | Në përgjigje të shkresës suaj…Ju sqarojmë se:<br>AZHT,e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së,është krijuar me Vendimin Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT", i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar,kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU-së me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU.<br>Për sa më lart,referuar kërkesës suaj,pas verifikimeve përkatëse kërkohet nga ana Juaj të na vini në dispzoicion dokumentacionin e plotë të pronësisë për pasurinë Tuaj (kartelë+ hartë treguese shoqëruese) dhe planin e rilevimit përkatës me koordinata të sakta në ssitemin referues KRGJSH 2010.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, | E plotë | Nuk ka |
| **10** | 13.03.2026 | Kthim përgjigje për shkresën….. | 24.03.2026 | Në përgjigje të kërkesës suaj…Ju bëjmë me dije se:<br>Nga verifikimi..në databazën e institucionit tonë rezultoi se, pasuria….e cituara në materialin bashkëlidhur kërkesës suaj, preket nga gjurma e aplikimit të depozituar pranë AZHT nëpërmjet sistemit elektronik e-leje.........<br>KKTU, me vendimin..ka miratuar me kusht lejen e ndërtimit për objektin....,vendim i cili ende nuk është zbardhur.<br>Të gjitha vendimet e zbardhura të KKTU,i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të AZHT: http://www.azht.gov.al,në rubrikën "Vendime KKTU".<br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin mbetemi në dizpozicion për çdo informacion apo dokumentacion të nevojshëm. | E plotë | Nuk ka |
| **11** | 15.03.2026 | Ankesë | 17.03.2026 | Në lidhje me kërkesën Tuaj, përcjellë elektronikisht, Ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon:<br>AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik iKKTU, në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, ka kompetencë *pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së.*<br>Në vijim ju sqarojmë se, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara, të cilën e përcjellin pranë institucionit tonë, për vijimin e procedurave administrative për miratimin e lejeve të ndërtimit për stacionet e plazhit nga KKTU, bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” si dhe akteve nënligjore në funksion të tij, VKM-në Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e ndryshuar.<br>Për sa më sipër, duke marrë parasysh shqetësimin tuaj, nga ana e institucionit tone po kryhen verifikimet e nevojshme mbi pretendimet tuaja, si dhe po kryhen korrespondencat me institucionet përkatëse. | E plotë | Nuk ka |
| **12** | 16.03.2026 | Ankesat e mia | 16.03.2026 | Në lidhje me kërkesën Tuaj, përcjellë nëpërmjet postës elektronike, lutemi t'i drejtoheni zyraebashkeqeverisjes@shqiperiaqedua.al | E plotë | Nuk ka |
| **13** | 17.03.2026 | Ankesë | 18.03.2026 | **Shënim**:Në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se: *“Kur një organ publik merr një kërkesë,për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet,ia përcjell kërkesën menjëherë,organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë”* , kërkesa është përcjell në organin publik kompetent,ku dhe kërkuesi është vendosur në dijeni për këtë. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **14** | 17.03.2026 | Kërkesë për informacion | 24.03.2024 | Në përgjigje të kërkesës Suaj...., depozituar nëpërmjet postës elektronike, me lëndë:"Kërkesë për informacion", me anë të së cilës kërkoni informacion rreth lejes së ndërtimit......, Ju sqarojmë si më poshtë vijon:<br>Pranë AZHT, si Sekretariat Teknik i KKT, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, aplikimi .......<br>Në lidhje me këtë aplikim, KKT...ka vendosur miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin:......<br>Në vijim ju bëjmë me dije se, pasi subjekti ka depozituar dokumentacionin e plotë si dhe ka plotësuar kushtet e Vendimit..., nga ana e institucionit tonë është vijuar<br>me Lëshimin e Dokumentit të Lejes së Ndërtimit.<br>Për sa i përket efekteve ligjore të Lejes së Ndërtimit ju sqarojmë se, në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 107/2015 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit* " i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në funksion të tij, është e nevojshme të kuptohet se momenti i miratimit të lejes së ndërtimit, pra pajisja e subjektit me dokumentin e lejes së ndërtimit, është i ndryshëm nga vendimi i miratimi i kërkesës për leje ndërtimi nga ana e KKTU-së.<br>Referuar Nenit 25, pika 5 dhe 6 të VKM-së 408 datë 13.05.2023 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit" e ndryshuar, përcaktohet se sekretariati pra AZHT, ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionin që shqyrtohet në mbledhjet e KKT, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU, si dhe kryen korrespoendencën me të gjitha autoritetet përgjegjëse, të cilat duhet të shprehen në lidhje me aplikimin.<br>Gjithashtu, po në Nenin 25 pika 9 po të VKM-së 408/2023, citohet se "...KKTU vendos për: a) miratimin e lejes së ndërtimit; b) refuzimin e lejes së ndërtimit; c) miratimin me kusht".<br>Vendimarrja në dispozitën sipërcituar konsiderohet si miratim në parim, por vetëm me lëshimin e Dokumentit të Lejes së Ndërtimit, zhvilluesi legjitimohet të fillojë punimet dhe zbatimin e projektit të miratuar.<br>Plotësimi i kushteve nga ana e zhvilluesit/aplikuesit, i dokumentit tekniko-ligjor, pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe tarifës së AZHT-së, janë veprime proçeduriale dhe ligjore që passjellin lëshimin e Dokumentit të Lejes së Ndërtimit nga ana e sekretariatit të KKTU-së.<br>Si përfundim, bazuar në argumentimin e mësipërm, theksojmë se, efektet ligjore të Lejes së Ndërtitmit, fillojnë me lëshimin e Dokumentit të Lejes së Ndërtimit, dokumenti i cili mban të gjitha specifikat e përcaktuara në Nenin 16 të VKM-së 408/2023 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit" (i ndryshuar).<br>Për sa më sipër, lutem gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, http://www.azht.gov.al<br>- Vendimin e KKT-së .....<br>- Hartën e planvendosjes së strukturave.<br>- Dokumentin e Rregullores së Veçantë.<br>- Dokumentin e Lejes së Ndërtimit ...... | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **15** | 17.03.2026 | Kërkesë | 01.04.2026 | Në përgjigje të shkresës Suaj….Ju sqarojmë se:<br>AZHT, si Sekretariat Teknik i KKTU krijuar me VKM-në Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, në përputhje me "Ligjin Nr.107/2014 Për planifikimin e territorit" i ndryshuar, të VKM-së Nr.408,datë 13.05.2015 "Mbi miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",i ndryshuar" është institucioni që kryen funksionet e sekretariatit teknik të KKT.<br>..........................<br>Për sa më sipër,në lidhje me çdo informacion mbi këtë procedurë ju sugjerojmë t'i drejtoheni Bashkisë..si autoriteti përkatës përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe vlerësimin e më pas miratimin e projekt propozimit.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, | E plotë | Nuk ka |
| **16** | 27.03.2026 | Kërkesë për vënie në dispozicion të dosjes së plotë administrative lidhur me procedurën e pajisjes me leje ndërtimi të pasuirsë…... | 01.04.2026 | …............<br>Sqarojmë se, AZHT kryen funskionin e Sekretariatit Teknik të KKTU dhe në përputhje me VKM-në Nr.725,datë 02.09.2015 *"Për mënyrën e organizimit dhe funskionimit të AZHT",* i ndryshuar, ka kompetencë për të pranuar, përgatitur dhe administruar dokumentacionin tekniko-ligjor që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU.<br>...................<br>Në lidhje me aplikimin e sipërcituar, KKTU ka miratuar me kusht........<br>..................<br>Për sa i përket kërkesës suaj për vënien në dispozicion të dosjes së plotë administrative,sjellim në vëmendjen tuaj Nenin 3 "E drejta e informimit",pika 4, të Ligjit Nr.119/2014 "*Për të drejtën e informimit",në të cilin citohet se: "Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji* ".Në zbatim të Ligjit Nr.9887,datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, bëjmë me dije se dokumentacioni i pronësisë dhe kontratat e sipërmarrjes së pronarëve të pasurive objekt zhvillimi përmbajnë të dhëna personale.<br>Gjithashtu,mbështetur edhe në Nenin 8 "Veprat",pika1,shkronjat "e" dhe "g",të Ligjit Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", institucioni jonë nuk mund të vërë në dispozicionin tuaj dokumentacionin teknik të depozituar nga subjekti zhvillues,pasi sipas përcaktimeve të këtij neni,veprat që janë objet i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë:<br>"*e)krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet,planet,skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore.<br>g)krijimet tredimensionale,ilustrimet,listat,hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë,gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi."*<br>Për sa më sipër,pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor,vendimin e sipërcituar së bashku me dokumentacionin që e shoqëron do të mund t'a aksesoni në faqen zyrtare të AZHT-së www.azht.gov.al,në Rubrikën "Vendime KKT". | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **17** | 27.03.2026 | *Shënim* : kërkesë pa objekt | 07.04.2026 | Në përgjigje të kërkesës Suaj, përcjellë elektronikisht, Ju bëjmë me dije se:<br>AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së.<br>Për sa më sipër, në mënyrë që të bëjmë një verifikim të detajuar, lutemi na përcillni dokumentacionin e pronësisë të plotë, si materialin hartografik, hartë treguese, genplan/ plan rilevimi me koordinata, në mënyrë që të bëjmë një verifikim më të detajuar, lidhur me pasurinë për të cilën kërkoni informacion.<br>Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm. | E plotë | Nuk ka |
| **18** | 30.03.2026 | Kërkesë për informacion | 14.04.2026 | Në përgjigje të kërkesës Suaj..., mbërritur përmes postës elektronike të AZHT-së info@azht.gov.al, ju bëjmë me dije se:<br>Pranë AZHT, si sekretariat teknik i KKT, janë depozituar aplikimet, për të cilat pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor janë lëshuar dokumentet e Lejes së Ndërtimit, konkretisht:<br>................................<br>Lidhur me kërkesën Tuaj për të ju vënë në dispozicion kopje të projektit arkitektonik, ju bëjmë me dije se me anë të shkresës ...... ju kemi vënë bashkëlidhur në formatin CD Vendimet e KKTU-së, Hartën e Planvendosjes së Strukturave, Dokumentet e Lejes së Ndërtimit si dhe projektet arkitektonike për secilin aplikim.<br>Mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm. | E plotë | Nuk ka |
| **19** | 31.03.2026 | Kërkesë për informim | 02.04.2026 | Në përgjigje të kërkesës Suaj.. mbërritur përmes postës elektronike të AZHT-së info@azht.gov.al, ju bëjmë me dije se:<br>Pranë AZHT, si sekretariat teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik e-leje aplikimi.... miratuar nga KKT me Vendimin.... për të cilin është lëshuar dhe Dokumenti i Lejes së Zhvillimit ...., për objektin e sipërcituar.<br>Referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në Nenin nr.7, "Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit", gërma ç), përcaktohet se:"KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj". Në përputhje me këtë dispozitë, Ju bëjmë me dije se në pikën nr.2 të Vendimit .., të sipërcituar, përcaktohet se pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë.<br>Në vijim, subjekti ka depozituar aplikimin protokolluar pranë AZHT-së .... për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin......<br>Në lidhje me aplikimin e sipërcituar, KKTU ka marrë Vendimin .... "Për miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: ...., për të cilin pas plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, AZHT ka lëshuar Dokumentin e Lejes së Ndërtimit .......<br>.......................<br>Për sa më sipër, Lidhur me distancat, ju bëjmë me dije se subjekti i është përmbajtur legjislacionit në fuqi "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", si dhe për pronën kufitare është marrë konfirmimi nga ASHK.<br>Bashkëlidhur këtij emaili gjeni përgjigjen e ASHK....... si dhe kartelat për pronat ......<br>Mbetimi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm | E plotë | Nuk ka |